



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 10

2003

Mars

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8996, datë 30.1.2003	Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë).....	275
Ligj nr. 9000, datë 30.1.2003	Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave.....	281
Vendim i KM nr. 664, datë 18.12.2002	Për kriteret dhe procedurat e shpalljes së gjendjes së emergjencës civile.....	290

L I G J
Nr. 8996, datë 30.1.2003

PËR NJËSITË E MATJES DHE KONTROLLIN E MJETEVE MATËSE (METROLOGJINË)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj vendos rregullat për organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e metrologjisë për përdorimin e Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve (SI), si dhe për kontrollin e mjeteve matëse.

Neni 2

Në këtë ligj fjalët e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. “Autorizim” kuptohet dhënia e së drejtës, për të kryer verifikime dhe kalibrime të mjeteve matëse në sferën e detyrueshme, subjekteve, publike ose private, vendase ose të huaja, që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

2. “Certifikim” kuptohet veprimtaria nëpërmjet së cilës një palë e tretë dhe e pavarur dëshmon zyrtarisht se një produkt, proces ose shërbim është në përputhje me kërkesat e paracaktuara në udhëzimet metodike të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit ose në standarde.

3. “Etalon” kuptohet masë matjeje, instrument matës, sistem matës, i paracaktuar që të realizojë, të ruajë ose të riprodhojë një njësi ose një a më shumë vlera të një madhësie, për t’ua transmetuar ato, me anë krahasimi, mjeteve të tjera matëse.

4. “Inspektim” kuptohet shqyrtimi i një produkti matës, shërbimi matës, procesi matës ose sistemi matës dhe përcaktimi i konformitetit të tyre me kërkesat specifike ose mbi bazë të një gjykimi profesional, me kërkesa të përgjithshme.

5. “Instrument matës” kuptohet pajisja e caktuar për të kryer matje, vetëm ose së bashku me pajisje shtesë.

6. “Kalibrim” kuptohet seria e veprimeve të kryera në kushte të caktuara, të cilat përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet vlerës së treguar nga mjete matës dhe vlerës korresponduese të realizuar nga etaloni i matjes.

7. “Matje” kuptohet seria e veprimeve për përcaktimin e vlerës së një madhësie.

8. “Material referues” kuptohet një material ose substancë që zotëron një ose më shumë cilësi tepër të stabilizuara, të cilat mund të përdoren për kalibrim të një aparati matës, vlerësimin e një metode matjeje ose të një vlere të paracaktuar të materialeve.

9. “Metrologji” kuptohet shkenca e matjeve.

10. “Mjete matëse” kuptohen masat matëse, instrumentet matëse, materialet referuese ose sistemet matëse.

11. “Njësi matjeje” kuptohet madhësia e caktuar, e pranuar me marrëveshje, për të shprehur në mënyrë sasiore madhësi të tjera të së njëjtës natyrë.

12. “Ruajtje e etalonit të matjes” kuptohen të gjitha veprimet e nevojshme për të ruajtur karakteristikat metrologjike të etalonit të matjes, brenda kufijve të caktuar.

13. “Transmetim” kuptohet cilësia e një rezultati matjeje, i cili është i rrjedhur nga një etalon i caktuar, kryesisht etalone ndërkombëtare ose kombëtare, nëpërmjet zinxhirit të pashkëputur të

krahasimeve.

14. “Verifikim” kuptohet konfirmimi nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit, që kërkesat specifike, tekniko-metrologjike, janë plotësuar.

15. “Vlerësim i konformitetit” kuptohet çdo veprimtari e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, që përcakton nëse është plotësuar tërësia e kërkesave teknike, të vendosura në dokumentacionin përkatës.

KREU II

NJËSITË LIGJORE TË MATJES

Neni 3

Njësitë ligjore të matjes në Republikën e Shqipërisë janë:

a) njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), të dhëna në nenin 4;

njësitë e pavarura nga SI-ja;

njësitë e rrjedhura nga SI-ja;

ç) shumëfishat dhe nënfishat dhjetorë të njësive SI.

2. Këshilli i Ministrave bën përcaktimin e njësive të matjes të pavarura dhe të rrjedhura nga SI-ja, si dhe shumëfishat dhe nënfishat dhjetorë të SI-së.

Neni 4

Njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI) janë:

Madhësia Emërtimi Simboli

Gjatësia metër m

Masa kilogram kg

Kohësekonde s

Intensiteti i rrymës elektrike amper A

Temperatura termodynamike kelvin K

Sasia e lëndës mol mol

Intensiteti i dritës kandelë cd

Neni 5

1. Përdorimi i njësive ligjore të matjes është i detyrueshëm:

a) për shkallëzimin dhe tregimet plotësuese për mjetet matëse që përdoren në tregti, shërbime, shëndetësi, higjienë, sigurimin teknik dhe mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet;

b) në tregti, në shpërndarje dhe në shërbime;

c) në aktet ligjore e nënligjore, kontratat, njoftimet, informacionet, në të gjitha aktet e tjera zyrtare, si dhe në tekstet shkollore, që përdoren brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Përdorimi i njësive ligjore nuk është i detyrueshëm për:

a) kontratat, që kanë për objekt pasuritë e paluajtshme që ndodhen jashtë shtetit;

b) aktet dhe mallrat, për të cilat marrëveshjet ndërkombëtare përcaktojnë përdorimin e njësive të tjera;

c) blerjen dhe përdorimin e materialeve ushtarake;

ç) tregimin e kohës sipas kalendarit.

KREU III

ORGANIZIMI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË DHE KALIBRIMIT

Neni 6

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit është person juridik publik, i specializuar për njësitë e matjes dhe kontrollin e tyre.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit ka qendrën në Tiranë dhe ka drejtoritë rajonale, degët në qarqe dhe zyrat e saj në rrethe.
3. Juridiksioni i ushtrimit të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit është i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë, ndërsa për drejtoritë rajonale territori përcaktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit.
4. Drejtori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri.
5. Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit ka këto detyra e të drejta:

- a) studion dhe propozon përmirësime të legjislacionit për metrologjinë dhe ia paraqet Këshillit të Ministrave;
- b) kontrollon zbatimin e ligjshmërisë për njësitë e matjes dhe kontrollin e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- c) harton dhe miraton metodika teknike për përkufizimin, vlerësimin dhe transmetimin e njësive të matjes së madhësive fizike; harton dhe miraton kërkesat metrologjike të mjeteve matëse, harton dhe miraton rregullat për laboratorët e kalibrimit, verifikimit, për organizmat certifikues, personelin e organizmave inspektues në fushën e metrologjisë, për certifikimin e mjeteve matëse, proceseve e sistemeve të matjes dhe personelit përkatës; përcakton afatet e detyrueshme për verifikimet periodike të mjeteve matëse, që përdoren sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 10 të këtij ligji;
- ç) përcakton saktësinë e mjaftueshme për njësitë e matjes, organizon transmetimin e tyre dhe kryen studime tekniko-shkencore;
- d) kontrollon mjetet matëse dhe vendos për miratimin, lejimin, verifikimin dhe kalibrimin e tyre;
- dh) kontrollon dhe kualifikon personelin e kontrollit të mjeteve matëse të sistemit të saj dhe verifikon e kalibron bazën e tyre etalonuese;
- e) plotëson laboratorët, ruan dhe zhvillon bazën etalonuese kombëtare të njësive të matjes, mostrat e materialeve referuese, në përputhje me nevojat e vendit, garanton saktësinë e tyre, duke i krahasuar periodikisht me etalonet ndërkombëtare në institucionet përkatëse jashtë shtetit;
- ë) përfaqëson Republikën e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare të metrologjisë;
- f) bashkëpunon me organizmat kombëtarë të metrologjisë së vendeve të tjera për arritjen e marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë, rajonale ose ndërkombëtare ose për të arritur marrëveshje dypalëshe;
- g) ushtron kontrolle teknike për saktësi matjeje në sektorë të ndryshëm të ekonomisë;
- gj) bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit dhe Drejtorinë Kombëtare të Akreditimit për drejtimin, organizimin, vlerësimin dhe inspektimin, në vazhdimësi, të veprimtarisë për akreditimin dhe certifikimin në fushën e metrologjisë;
- h) jep ndihmë teknike dhe merr pjesë në ekspertiza dhe kontrolle teknike për problemet e metrologjisë edhe me specialistë të jashtëm;
- i) pajis punonjësit e vet me vula teknike identifikimi të kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse;
- j) miraton kampionët e rinj të mjeteve matëse që prodhohen brenda vendit, si edhe kërkesat metrologjike të tyre;
- k) bën njohjen e miratimeve dhe të kalibrimeve të kryera jashtë shtetit dhe lejon përdorimin e mjeteve matëse të importuara, që përdoren në sektorët e përmendur në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 10 të këtij ligji.

Neni 8

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit krijohet dhe funksionon Këshilli i Metrologjisë, i cili është organ këshillimor pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Metrologjisë dhe Kalibrimit.

Organizimi dhe funksionimi i këtij organi përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 9

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit, me të ardhurat nga veprimtaria e vet, mbulon shpenzimet dhe diferenca ndërmjet tyre financohet nga shteti në formën e granteve ose subvencioneve shtetërore dhe, nga pikëpamja financiare, administrimi i fondeve i nënshtrohet legjislacionit të institucioneve buxhetore.

KREU IV

KONTROLLI I MJETEVE MATËSE

Neni 10

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit përcakton karakteristikat metrologjike të mjeteve matëse që përdoren:

- a) në tregti, në shpërndarje dhe në shërbime;
- b) në sektorët e shëndetësisë, të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

2. Mjetet matëse që përdoren sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni, u nënshtrohen procedurave të vlerësimit të konformitetit dhe të kalibrimit ose verifikimit, para vënies së tyre në përdorim.

3. Mjetet matëse, që përdoren sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni, vulojnë pas çdo verifikimi e kalibrimi.

4. Organizmat që kryejnë certifikimin, dhënie e lejes së vënies në shfrytëzim dhe kontrollin teknik periodik të makinerive dhe pajisjeve që kanë mjete matëse dhe përdoren në fushat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni, duhet të marrin, paraprakisht, dëshminë për gjendjen e rregullt teknike të mjeteve matëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit.

Neni 11

1. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit dhe të drejtorive, degëve e zyrave të saj, brenda juridiksionit të veprimtarisë së tyre, kanë të drejtë për të marrë të dhëna dhe për të hyrë lirisht e pa pagesë në objektet që i nënshtrohen kontrollit.

2. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, sipas juridiksionit të përcaktuar, kryejnë regjistrimin, verifikimin dhe kalibrimin e mjeteve matëse, të përmendura në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 10 të këtij ligji.

3. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit ushtrojnë kontrolle, sipas juridiksionit të përcaktuar, për të verifikuar nëse mjetet matëse në përdorim janë të regjistruara dhe, për çdo rast, marrin masat përkatëse.

4. Për verifikimet dhe kalibrimet që nuk i kryen dot vetë, i propozon Këshillit të Ministrave të autorizojë laboratorë të tjerë.

Neni 12

Personat fizikë ose juridikë, që vënë në përdorim mjete matëse për qëllime tregtimi, shërbimi, sigurimi teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, detyrohen të bëjnë regjistrimin, verifikimin dhe kalibrimin fillestar dhe periodik të tyre te punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit në juridiksionin ku veprojnë.

Neni 13

1. Personat fizikë ose juridikë që kanë në përdorim mjete matëse, janë të detyruar t'i kontrollojnë dhe, nëse rezultojnë se nuk janë të rregullta, të marrin masa për rregullimin e tyre. Pas çdo riparimi ata detyrohen të njoftojnë menjëherë punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, për të bërë verifikimin dhe rikalibrimin e tyre.

2. Mjetet matëse të cilat gjatë kontrollit nuk rezultojnë në rregull, bllokohen dhe hiqen nga përdorimi nga punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit. Për ushtrimin e kësaj kompetence punonjësit e kësaj drejtorie bashkëpunojnë me organet e rendit.

Neni 14

1. Personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtari në tregti dhe në shpërndarje mallrash ose në shërbimet e matshme, janë të detyruar ta tregojnë sasinë e ofruar në njësi ligjore. Në rastin e tregtimit të mallrave, të punimeve e të shërbimeve të matshme, sasia e tyre duhet të tregohet në çdo pako, ambalazh ose shërbim.

2. Personat fizikë ose juridikë, që tregtojnë mallra të paraambalazuara dhe që kryejnë shërbime të matshme, detyrohen ta tregojnë sasinë.

3. Pakot ose produktet e paketuara për tregtim duhet të kenë mbishkrime të qarta dhe të sakta për sasinë.

4. Pakot ose mallrat e paketuara, përmbajtja në sasi e të cilave gjatë kontrollit nuk përputhet me mbishkrimet, bllokohen menjëherë dhe ndalohet shpërndarja e tyre, si dhe njoftohen organet përkatëse.

Neni 15

Regjistrimi, lejimi, miratimi i tipit, verifikimi e kalibrimi fillestar dhe periodik i mjeteve matëse kryhen kundrejt tarifave të miratuara. Këto tarifa propozohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit dhe miratohen nga Ministria e Financave. Tarifat janë të njëjta si për subjektet vendase, edhe për ato të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtari prodhimi ose shërbimi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 16

Ndalohen importimi, prodhimi dhe përdorimi i mjeteve matëse në territorin e Republikës së Shqipërisë pa miratimin ose lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit.

KREU V

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET

Neni 17

Janë kundërvajtje administrative, kur nuk përbëjnë vepër penale:

përdorimi i njësive joligjore të matjes;

prodhimi ose përdorimi i mjeteve matëse të pamiratuara;

shpërndarja e mjeteve matëse të pasakta nga prodhimi ose riparimi;

ç) moskryerja e kontrollit dhe e verifikimit të mjeteve matëse dhe etaloneve të njësive të matjes;

d) mosregjistrimi i mjeteve matëse në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit;

dh) përdorimi i mjeteve matëse nën kufirin minimal dhe mbi kufirin maksimal të lejuar;

e) përdorimi i mjeteve matëse të pasakta, që kalojnë kufijtë e shmangieve të lejuara me akte ligjore e nënligjore;

ë) përdorimi i mjeteve matëse, të cilave u mungon dokumenti dhe vula e kontrollit mbi mjetin

matës;

- f) përdorimi i mjeteve matëse, që u ka kaluar afati i kontrollit;
- g) ndërhyrja ose falsifikimi në mjetin matës, të verifikuar ose të kalibruar;
- gj) mosvënia e mbishkrimit të sasisë, sipas kërkesave të nenit 14 të këtij ligji;
- h) tregtimi i mallrave të ambalazuara ose të paraambalazuara, sasia e të cilave nuk është në përputhje me mbishkrimet.

Neni 18

1. Personat fizikë ose juridikë, që kryejnë kundërvajtje administrative, sipas nenit 17 të këtij ligji, dënohen nga punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit me gjobë. Vlera e gjobës për biznesin e vogël, shitësit me pakicë është nga 10 000 deri në 50 000 lekë dhe për biznesin e madh, shitësit me shumicë, prodhuesit dhe shpërndarësit është 500 000 lekë. Në rast përsëritjeje të së njëjtës kundërvajtje gjoba dyfishohet.

2. Gjoka i dërgohet për vjelje zyrtarisht bashkisë ose komunës, ku kundërvajtësi ka vendbanimin ose kryen veprimtarinë kryesore.

Neni 19

1. Kundër vendimit të dënimit me gjobë, të dhënë nga punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve te Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, i cili brenda 15 ditëve duhet të bëjë shqyrtimin e ankimit.

2. Kundër vendimit të Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e dhënies së vendimit.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 20

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3 dhe 6 të këtij ligji.

Neni 21

Ligji nr.7625, datë 20.10.1992 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)”, shfuqizohet.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3714, datë 28.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

L I G J

Nr. 9000, datë 30.1.2003

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të neneve 6, 81 pika 2 shkronja “a” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit, të ministrit, të institucioneve në varësi të tyre, të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, marrëdhëniet ndërmjet tyre, si dhe aktet nënligjore, që nxjerrin këto organe.

KREU II

ORGANIZIMI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Neni 2

Kryeministri

1. Kryeministri, përveç kompetencave të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje të veçanta, ushtron edhe këto kompetenca:

- a) përfaqëson dhe drejton Kryeministrinë;
- b) u kërkon ministrave përgjegjës shpjegime, relitime dhe verifikime administrative, për çështje të fushës që ata mbulojnë;
- c) pezullon zbatimin e akteve të ministrave, të drejtuesve të institucioneve qendrore, në varësi të tij ose të ministrave, me nismën e vet ose me kërkesë të subjekteve të interesuara, kur konstaton shkelje të Kushtetutës, të ligjeve, ose të akteve të Këshillit të Ministrave.

2. Me miratimin e Këshillit të Ministrave, Kryeministri mund të marrë përsipër edhe detyra të tjera.

Neni 3

Kryeministria

1. Kryeministria është person juridik, publik, që mbështet veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit dhe të Ministrit të Shtetit.

2. Kryeministria e ka selinë në Tiranë.

Neni 4

Struktura dhe përbërja

1. Kryeministria përfshin: aparatin e Këshillit të Ministrave, kabinetin e Kryeministrit, kabinetin e Zëvendëskryeministrit dhe kabinetin e Ministrit të Shtetit.

2. Struktura dhe organika e Kryeministrit përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Emërimi, lirimi ose shkarkimi i të punësuarve të kabineteve, bëhet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e kryesuesit të kabinetit. Të punësuarit e kabineteve gëzojnë statusin e funksionarit politik.

Neni 5
Zëvendëskryeministri

1. Zëvendëskryeministri zëvendëson Kryeministrin, në kuptimin e pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurave Administrative.

2. Zëvendëskryeministri kryen detyra, që parashikohen në ligje të veçanta, si dhe ato që i ngarkohen nga Këshilli i Ministrave ose nga Kryeministri.

Neni 6
Ministri dhe zëvendësministri

1. Ministri, përveç kompetencave ose detyrave që parashikohen në Kushtetutë dhe në ligje të veçanta, ushtron edhe detyra të tjera, që i ngarkohen nga Këshilli i Ministrave ose nga Kryeministri.

2. Zëvendësministri zëvendëson ministrin, në kuptimin e pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurave Administrative. Zëvendësministri emërohet dhe lirohet nga detyra nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit. Me urdhër të ministrit, zëvendësministrit i caktohen edhe detyra të tjera.

Neni 7
Ministria

1. Ministria është person juridik, publik, që përfaqësohet dhe drejtohet nga ministri. Ministria mbështet, në aspektin teknik, veprimtarinë e ministrit.

2. Fusha e veprimtarisë shtetërore, që përfshihet brenda një ministrie, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

3. Struktura dhe organika e ministrisë përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përkatës.

4. Rregullat e hollësishme të organizimit dhe funksionimit të ministrisë përcaktohen në rregulloren e brendshme, që miratohet nga ministri.

5. Emërimi, lirimi ose shkarkimi i funksionarëve politikë të ministrisë bëhet me urdhër të ministrit.

Neni 8
Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave

1. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave është nëpunësi më i lartë civil i Këshillit të Ministrave.

2. Sekretari i Përgjithshëm emërohet në detyrë sipas procedurave të parashikuara në nenin 13 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Sekretari i Përgjithshëm lirohet ose largohet nga detyra sipas përcaktimeve të parashikuara në nenet 21, 24 dhe 25 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Neni 9
Kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca:

- a) organizon dhe asiston në mbarëvajtjen e mbledhjeve të Këshillit të Ministrave;
- b) ndjek procesin e vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave të Ministrave, që nga paraqitja e projektakteve për shqyrtim e derisa aktet marrin fuqi ligjore, në kuptim të Kushtetutës;
- c) kthen, në bazë të argumenteve ligjore, projektaktet e paraqitura për shqyrtim, kur ato bien në kundërshtim me Kushtetutën ose me ligjin;
- ç) i parashtron Kryeministrit përputhshmërinë e projektakteve të propozuara me legjislacionin në fuqi dhe me programin politik të Këshillit të Ministrave;

d) përgatit, pas këshillimit me Kryeministrin, programet afatshkurtra dhe afatmesme të veprimtarisë së Këshillit të Ministrave;

dh) drejton aparatin e Këshillit të Ministrave për të përmbushur funksionin mbështetës të veprimtarisë së Këshillit të Ministrave;

e) administron buxhetin dhe është titullar i entit prokurues të Kryeministrit.

2. Këshilli i Ministrave ose Kryeministri mund t'i caktojë Sekretarit të Përgjithshëm edhe detyra të tjera.

Neni 10

Institucionet qendrore

1. Institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit ose të ministrit, janë persona juridikë, publikë, që krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave, për të ushtruar veprimtarinë shtetërore në një fushë të caktuar.

2. Statusi, objekti i veprimtarisë, organizimi i brendshëm, emërimi, lirimi ose shkarkimi i drejtuesit të institucionit qendror dhe çështje të tjera për to, parashikohen në vendimin e Këshillit të Ministrave, me të cilin ato krijohen.

3. Struktura dhe organika e tyre, përveç rasteve kur ato rregullohen me ligj, përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, përkatësisht për institucionet në varësi të Kryeministrit, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm, ndërsa për institucionet në varësi të ministrit me propozimin e këtij të fundit.

Neni 11

Komitetet ndërministrore

1. Komitetet ndërministrore janë organe konsultative të Këshillit të Ministrave, ku diskutohen paraprakisht politikat, çështjet e rëndësishme të veprimtarisë ekzekutive, si dhe projektaktet e një rëndësie të veçantë.

2. Komitetet ndërministrore kryesohen nga Kryeministri. Në raste të veçanta dhe me miratimin e tij mund të kryesohen nga Zëvendëskryeministri ose ministri i fushës përkatëse. Ngritja, përbërja, fusha e veprimtarisë që shqyrtojnë dhe të ftuarit në mbledhjet e tyre, përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

Neni 12

Grupet e punës me ekspertë

1. Grupet e punës me ekspertë për hartimin e strategjive, të politikave, të studimeve ose të projektakteve të veçanta krijohen me urdhër të Kryeministrit ose të ministrit për ministrinë përkatëse.

2. Ekspertë mund të caktohen edhe persona, që nuk punojnë në administratën shtetërore. Shpërblimi i ekspertëve të grupeve të punës përballohet nga fondet e Buxhetit të Shtetit ose të ndihmës së huaj për atë qëllim, ndërsa masa dhe mënyra e pagesës së shpërblimit përcaktohen me urdhrin përkatës të Kryeministrit.

KREU III

FUNKSIONIMI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Neni 13

Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

1. Mbledhja e Këshillit të Ministrave thirret nga Kryeministri ose, në mungesë dhe me porosi të tij, nga Zëvendëskryeministri.

2. Në mbledhjet e Këshillit të Ministrave shqyrtohen projektaktet dhe çështjet e parashikuara në rendin e ditës. Me miratimin e Kryeministrit në mbledhje shqyrtohen edhe çështje të tjera, që nuk kanë lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve, të cilat nuk janë të përfshira në rendin e

ditës.

3. Mbledhja e Këshillit të Ministrave është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

4. Kur, për shkaqe të arsyeshme, ministri nuk mund të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, atëherë ai duhet të njoftojë paraprakisht Kryeministrin dhe në vend të tij, me miratimin e këtij të fundit, merr pjesë, pa të drejtë vote, zëvendësministri.

5. Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave merr pjesë rregullisht, pa të drejtë vote, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

Në raste të veçanta, sipas rëndësisë dhe problematikës së çështjeve të përfshira në rendin e ditës, mund të ftohen të marrin pjesë edhe persona të tretë, ekspertë.

Neni 14

Mbledhjet e jashtëzakonshme të Këshillit të Ministrave

1. Në raste të veçanta, Këshilli i Ministrave thirret në mbledhje të jashtëzakonshme nga Kryeministri ose, në mungesë dhe me porosi të tij, edhe nga zëvendëskryeministri.

2. Në rastet e thirrjes së mbledhjes të jashtëzakonshme nuk zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji.

Neni 15

Rendi i ditës

1. Rendi i ditës i mbledhjeve të Këshillit të Ministrave përgatitet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, pasi këshillohet me Kryeministrin.

2. Në rendin e ditës përfshihen projektaktet, që plotësojnë kërkesat e parashikuara në nenet 23, 24, 25 dhe 26 të këtij ligji, të propozuar nga anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe çështje të tjera, që Kryeministri i çmon se duhen shqyrtuar.

3. Rendi i ditës dhe projektaktet, që do të paraqiten për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, duhet t'u dërgohen anëtarëve të Këshillit të Ministrave të paktën 2 ditë përpara datës së caktuar për thirrjen e mbledhjes.

Neni 16

Shfaqja e mendimit

Çdo anëtar i Këshillit të Ministrave ka të drejtë të shfaqë në mbledhje mendimin e vet dhe të ushtrojë të drejtën e votës për projektaktet, objekt shqyrtimi.

Neni 17

Besueshmëria dhe solidarësia

1. Anëtarët e Këshillit të Ministrave duhet t'i respektojnë vendimet e marra në mbledhjet e Këshillit të Ministrave. Ata duhet të mënjanojnë në mënyrë të veçantë çdo shprehje mospajtimi dhe të mbrojnë ose të përkrahin vendimet e lartpërmendura, pavarësisht nga fakti nëse kanë marrë pjesë ose jo në mbledhje, ose nëse kanë votuar pro ose kundër tyre.

2. Vlerësimet, debatet dhe raportimet mbeten kofidenciale.

Neni 18

Garantimi i paanshmërisë së anëtarëve të Këshillit të Ministrave

1. Anëtari i Këshillit të Ministrave nuk mund të marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, nëse ka interes personal ndaj saj, ose në çdo rast tjetër, kur vërtetohen arsye serioze njëanshmërie.

2. Kërkesa për të mos marrë pjesë në vendimmarrje për çështjen, objekt shqyrtimi, i paraqitet Kryeministrit, kur anëtari ka dijeni, përpara mbledhjes së Këshillit të Ministrave ose drejtpërdrejt në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, kur gjatë shqyrtimit të çështjes ai çmon se paraqitet njëri nga shkaqet e parashikuara më lart.

3. Kërkesa që një anëtar i Këshillit të Ministrave të mos marrë pjesë në vendimmarrjen e një çështjeje, për të cilën ka interes personal, bëhet edhe nga Kryeministri, kur ai ka dijeni për këtë gjë, ose kur propozohet nga një anëtar tjetër i Këshillit të Ministrave.

Neni 19

Shqyrtimi i projektakteve

1. Këshilli i Ministrave, pas shqyrtimit të projektaktit në mbledhje, vendos miratimin, miratimin me ndryshime, shtyrjen për shqyrtim të mëvonshëm ose mosmiratimin.
2. Projektakti mund të tërhiqet nga propozuesi në çdo kohë, deri para votimit të tij.

Neni 20

Vendimmarrja

Aktet e Këshillit të Ministrave miratohen me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit të Ministrave, me votim të hapur.

Neni 21

Procesverbali i mbledhjes

1. Në mbledhjet e Këshillit të Ministrave mbahet procesverbal, ku shënohen data, vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, aktet që u shqyrtuan, diskutimet e pjesëmarrësve, si dhe forma e rezultati i votimit.
2. Procesverbali u paraqitet, përpara mbledhjes pasardhëse, anëtarëve të Këshillit të Ministrave, nëse një gjë e tillë kërkohet nga vetë ata. Në këtë rast, ata kanë të drejtë të paraqesin vërejtje për përmbajtjen e tij, kur nuk është pasqyruar saktësisht qëndrimi i tyre në mbledhje.
3. Procesverbali nënshkruhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.
4. Rregullat e hollësishme për përmbajtjen e procesverbalit caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 22

Njoftimi

1. Pas çdo mbledhjeje të Këshillit të Ministrave, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave harton një raport përfundimtar për problemet e përgjithshme, të shqyrtuara në mbledhje, i cili bëhet publik.
2. Rregullat e hollësishme për mënyrën e ndërtimit dhe formën e raportit përfundimtar caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 23

Procesi i hartimit të projektakteve

1. Hartimi i projektakteve, që shqyrtohen nga Këshilli i Ministrave, ose i materialeve të tjera, me karakter raportues e njoftues, bëhen nën mbikëqyrjen e Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ministrit ose titullarit të institucionit qendror përkatës.
2. Rregullat dhe procedurat e hollësishme për hartimin e projektakteve caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 24

Bashkërendimi

1. Propozuesit e projektakteve jua dërgojnë për mendim ministrave dhe institucioneve të tjera të interesuara projektaktin dhe një relacion shpjegues për objektin, qëllimin dhe përmbajtjen e tij.
2. Në çdo rast projektaktet, përveç atyre me karakter individual, i dërgohen për mendim Ministrit të Drejtësisë, i cili shprehet për ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes së tyre.
3. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, jua kthen për plotësim ministrave

propozues projektaktet, kur ato nuk përmbushin kriteret dhe kushtet e paraqitjes së tyre, të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet e Këshillit të Ministrave, në bazë e për zbatim të tij.

4. Rregullat dhe procedurat e hollësishme për bashkërendimin e projektakteve caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 25

Përmbajtja e projektakteve

1. Propozimet e projektakteve, që paraqiten për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave, duhet të përmbajnë projektaktin, relacionin, mendimet ose vërejtjet e ministrive ose të institucioneve të interesuara, dokumentacionin që shoqëron projektaktin, në varësi të kërkesave të ligjit ose të përmbajtjes së tij, si dhe përmbledhjen që do të përfshihet në komunikatën për mediat.

2. Relacionet duhet të përmbajnë:

a) objektivat që synohen të arrihen, lidhjen ose jo me programin politik të Këshillit të Ministrave;

b) argumentin që objektivat e projektaktit nuk mund të arrihen me instrumentet ekzistuese ligjore;

c) përmbledhjen e përmbajtjes së projektaktit;

ç) përputhshmërinë me Kushtetutën dhe harmonizimin me legjislacionin në fuqi. Në rastin e projektligjeve, të akteve normative me fuqinë e ligjit dhe të akteve normative edhe shkallën e përputhshmërisë së projektaktit me të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë;

d) shpjegimin për marrjen ose jo parasysh të vërejtjeve dhe të mendimeve të ministrive ose të institucioneve të tjera të interesuara.

3. Për projektaktet me karakter financiar-ekonomik, relacioni duhet të përmbajë edhe efektet e pritshme financiare, që rrjedhin nga zbatimi i tyre.

4. Rregullat dhe procedurat e hollësishme për përmbajtjen e projektakteve, të parashikuara në këtë nen, caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 26

Paraqitja e projektakteve

Projektaktet, që u përkasin institucioneve të tjera qendrore, në varësi të Kryeministrit ose të ministrit përkatës, paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, me propozimin e Kryeministrit ose të ministrave përkatës.

Neni 27

Programimi dhe raportimi

1. Anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe titullarët e institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit, dërgojnë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave propozimet për programet analitike vjetore, të ndara në katërmujorë, të projektakteve që do të paraqesin për shqyrtim në Këshillin e Ministrave.

2. Në bazë të propozimeve të dërguara, hartohen programet vjetore të Këshillit të Ministrave, të bashkërenduara me programin e përgjithshëm të tij dhe me programin ligjvënës të Kuvendit. Këto programe miratohen në mbledhjet e Këshillit të Ministrave.

3. Njëri nga anëtarët e Këshillit të Ministrave, i caktuar nga Kryeministri, bashkërendon programin ligjvënës të Kuvendit me programin politik të Këshillit të Ministrave.

4. Anëtarët e Këshillit të Ministrave, periodikisht dhe në fund të çdo viti, u paraqesin Kryeministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave një raport për zbatueshmërinë e akteve, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, për fushat që mbulojnë dhe veprimtarinë që ata drejtojnë, në zbatim të programit politik të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

AKTET

Neni 28

Llojet e akteve

Llojet e akteve të institucioneve të pushtetit ekzekutiv janë:

- a) akti normativ, që është akti që nxjerr Këshilli i Ministrave në zbatim të nenit 116 të Kushtetutës;
- b) vendimi me karakter normativ, që është akti nënligjor i Këshillit të Ministrave që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje;
- c) vendimi me karakter individual, që është akti nënligjor i Këshillit të Ministrave, që rregullon një marrëdhënie konkrete, ose që u drejtohet një ose disa subjekteve, individualisht të përcaktuara, të së drejtës;
- ç) udhëzimi, që është akti nënligjor i Këshillit të Ministrave, i ministrit ose drejtuesit të institucionit qendror, në varësi të Kryeministrit ose të ministrit, me karakter shpjegues, që shtjellon me hollësi të gjitha urdhërimet e ligjit ose të vendimit të Këshillit të Ministrave;
- d) urdhri, që është akti nënligjor i Kryeministrit, i ministrit ose drejtuesit të institucionit qendror, në varësi të Kryeministrit ose ministrit, që ka karakter të brendshëm, që mund të vendosë rregulla sjelljeje, të përgjithshme, ose mund të rregullojë një marrëdhënie konkrete.

Neni 29

Hyrja në fuqi e akteve

1. Aktet normative, me fuqinë e ligjit, të Këshillit të Ministrave botohen menjëherë në Fletoren Zyrtare.
2. Vendimet e Këshillit të Ministrave marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare. Për vendimet me karakter normativ mund të caktohet si datë hyrjeje në fuqi një datë tjetër nga ajo e botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi menjëherë, por botohen në Fletoren Zyrtare.
3. Udhëzimet e Këshillit të Ministrave dhe të ministrit marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare.
4. Urdhrat e Kryeministrit, të ministrit ose të drejtuesit të institucionit qendror, në varësi të Kryeministrit ose të ministrit, hyjnë në fuqi menjëherë, u njoftohen të interesuarve dhe shpallen, për të paktën 3 ditë, në një vend të dukshëm të institucionit përkatës.

Neni 30

Ankimi ndaj akteve

1. Subjekti, që i është cenuar një e drejtë ose një interes i ligjshëm, ka të drejtë të ankohet te Kryeministri, kundër aktit të ministrit ose të drejtuesit të institucionit qendror, në varësi të Kryeministrit, sipas procedurave të parashikuara në nenet 135-146 të Kodit të Procedurave Administrative.
2. Subjektet, që gëzojnë statusin e funksionarit politik, nuk kanë të drejtë të paraqesin ankim kundër aktit të ministrit ose drejtuesit të institucionit qendror në varësi të Kryeministrit, me pretendimin se u është cenuar një e drejtë ose interes i ligjshëm.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 31

Marrëdhëniet me të tretët

1. Projektligjet dhe aktet normative me fuqinë e ligjit, që propozohen për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, mbrohen në emër të Këshillit të Ministrave nga anëtarët e Këshillit të Ministrave,

propozues të këtyre projekteve.

2. Aktet e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të ministrit ose të drejtuesit të institucionit qendror, në varësi të Kryeministrit, që janë objekt shqyrtimi gjyqësor ose në Gjykatën Kushtetuese, mbrohen nga Avokati i Shtetit.

Neni 32
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që, në zbatim të pikës 4 të nenit 21, të pikës 2 të nenit 22, të pikës 2 të nenit 23, të pikës 4 të nenit 24 dhe të pikës 4 të nenit 25, të miratojë Rregulloren e Këshillit të Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 33
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3723, datë 28.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

V E N D I M
Nr. 664, datë 18.12.2002

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E SHPALLJES SË GJENDJES SË EMERGJENCËS CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 dhe 35 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Gjendja e emergjencës civile mund të shpallet në një pjesë të territorit ose në të gjithë territorin e vendit.
2. Gjendja e emergjencës civile shpallet kur në mundësitë dhe burimet që zotërohen nëkushte normale nuk mund të përballohen pasojat e shkaktuara nga fatkeqësia.
3. Për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile janë të nevojshme të dhënat e mëposhtme:
 - a. shtrirja territoriale e zonës së dëmtuar;
 - b. ndikimet e këtyre dëmeve në prishjen e ekuilibrave të jetës normale të komunitetit;
 - c. të dhënat shkencore nga institutet përkatëse, për rastin konkret të fatkeqësisë.
4. Në rast tërmeti, mund të shpallet gjendja e emergjencës civile, për shkak të fatkeqësisë natyrore kur sigurohen të dhënat sipas përcaktimeve të pikës 5 të këtij vendimi.

Procedurat që ndiqen për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile në rast tërmeti janë:

 - a. Instituti Sizmiologjik, brenda 2 orëve jep në Departamentin e Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile, të dhënat e para, të regjistruara dhe, në mënyrë periodike, plotëson këto të dhëna deri në shuarjen përfundimtare të goditjeve sizmike.
 - b. Departamenti i Planizimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile, paraqet raportin njohës për Ministrin e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, pas marrjes së të dhënave, për dëmet e shkaktuara e vlerësimin paraprak të gjendjes nga Instituti sizmiologjik, komuna a bashkia dhe qarku.
 - c. Këshilli i Ministrave, pas mbledhjes së të dhënave të nevojshme, vendos shpalljen e gjendjes së emergjencës për atë pjesë territori.
5. Në rastet e përmytjeve mund të shpallet gjendja e emergjencës civile kur:
 - a. niveli i ujrave arrin pika kritike, në disa zona të matshme;
 - b. një ose më shumë lumenj, që përshkojnë vendin, kanë dalë jashtë shtratit, në përmasa të

rrezikshme;

c. prita rezervuarësh dhe diga liqenesh janë dëmtuar rëndë;

ç. jeta e popullsisë civile, e gjësë së gjallë dhe prona janë rrezikuar seriozisht.

6. Procedura për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile në rastin e përmbytjeve të jetë e njëjtë me procedurën e përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi. Të dhënat e regjistruara do të jepen nga Instituti Hidrometeorologjik dhe/ose nga organet e qeverisjes vendore, rast pas rasti dhe periodikisht, çdo 4 orë nga fillimi i reshjeve.

7. Këshilli i Ministrave pas mbledhjes së të dhënave të nevojshme, shpall gjendjen e emergjencës civile në një zonë të caktuar ose në të gjithë vendin, kur shtrirja e kësaj emergjence i kalon mundësitë për t'u përballuar nga qarku dhe kërkohet të vihen në punë burimet e qarqeve fqinje ose të niveleve qendrore.

8. Kriteret kryesore për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile për fatkeqësitë, si rezultat i veprimit të njerëzve, epidemive, aksidenteve industriale dhe rrezatimeve radioaktive, etj, përcaktohen, rast pas rasti, sipas efekteve që do të kenë në zonën e goditur dhe sipas mundësive që ekzistojnë për përballimin e tyre, në nivelet e qeverisjes vendore.

9. Propozimi për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile në këto raste ndërmerret nga ministritë e linjës sipas veçorive të fenomeneve që shfaqen, si dhe të kompetencave e funksioneve që mbulojnë, në bashkëpunim me institutet përkatëse dhe organet e qeverisjes vendore, të prekura nga fatkeqësia.

10. Ngarkohen të gjitha ministritë, institutet kërkimore e shkencore përkatëse, entet publike, që kanë lidhje me emergjencat, dhe organet e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 10.3.2003
Doli nga shtypi më 10.3.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë